

## Vendim nr. 150 datë 28.06.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Genti Ibrahim, i,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 28.06.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 4 (K) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUESE:** **KRISTINA GJICA**, e përfaqësuar me prokurë nga avokate Elona Kanapari.

**OBJEKTI:** **Shfuqizimi i vendimeve nr. 10-2015-1701 (745), datë 21.07.2015 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2023-5519, datë 13.12.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

**BAZA LIGJORE:** **Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuësja dhe shtetasja E.Gj. janë vajzat e të ndjerit J.Gj., i cili ka ndërruar jetë në vitin 2011. Mbi kërkesën e të atit, të J.GJ., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 13-2011-2206 (1048), datë 06.05.2011, ka lëshuar dëshminë testamentare në bazë të testamentit nr. 63, datë 19.11.2010, duke përcaktuar si trashëgimtarë testamentarë prindërit e tij, të atin K.Gj. dhe të ëmën Th.Gj. Rezulton që në vitin 2012 të ketë ndërruar jetë dhe babai i trashëgimlënësit, shtetasi K.Gj.

2. Po në vitin 2012 shtetasja E.Gj., motra e kërkuësës, i është drejtuar gjykatës, duke kërkuar lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për të atin dhe gjyshin e saj. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 13-2013-282 (115), datë 18.01.2013, ka vendosur, ndër të tjera, lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për trashëgimlënësin, duke përcaktuar si trashëgimtare ligjore të radhës së parë vajzat e tij, të cilat do të trashëgonin në pjesë të barabarta prej 1/2-ës secila.

3. Kërkuësja ka pretenduar se gjatë atij procesi gjyqësor, në momentin e çeljes së dëshmisë së trashëgimisë, ajo dhe e motra kanë marrë dijeni për ekzistencën e testamentit të babait të tyre. Pasi janë njohur me një kopje të testamentit, kanë konstatuar se nuk ishte nënshkruar nga i ati. Në këto kushte ato i janë drejtuar gjykatës për të kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të testamentit, për shkak se babai i tyre vuante nga një sëmundje e rëndë që i ka marrë dhe jetën, arsye për të cilën ai nuk mund të kishte nënshkruar atë testament dy muaj përpara se të ndërronte jetë. Kërkuësja dhe e motra kanë kërkuar edhe njohjen dhe thirrjen e tyre si trashëgimtare ligjore të radhës së parë dhe dorëzimin e pasurisë trashëgimore nga trashëgimtarët testamentarë. Në gjykim, në cilësinë e të paditurve janë thirrur e ëma e trashëgimlënësit, Th.GJ., si trashëgimtare testamentare, si dhe shtetaset V.Gj. e M.S. (hallat e kërkuësës), të cilat kanë hyrë me zëvendësim në vend të të atit të ndjerë, trashëgimtar testamentar i pasvdekur i të birit të paravdekur. Në gjykim është thërritur një ekspert grafik, i cili ka përgatitur aktin e ekspertimit për nënshkrimin e trashëgimlënësit, në konkluzion të të cilit ekzemplarët e nënshkrimit në testament nuk kanë rezultuar të njëjtë me shumicën e modeleve të nënshkrimit të trashëgimlënësit, por përshtateshin vetëm me njërin prej atyre modeleve.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 1594 (4244), datë 09.07.2013, ka vendosur, në mënyrë të përmbledhur, pranimin e kërkesëpadisë dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të testamentit, si dhe njohjen dhe thirrjen në trashëgim të kërkuësës dhe motrës së saj, si trashëgimtare ligjore të radhës së parë të trashëgimlënësit. Kundër

vendimit kanë paraqitur ankim Th.Gj., gjyshja e kërkueses, dhe V.Gj. e M.S., hallat e kërkueses. Kjo e fundit ka hequr dorë më pas nga ankimi.

5. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2015-1701 (745), datë 21.07.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit e gjykatës së shkallës së parë dhe ka rrëzuar kërkesëpadinë si të pabazuar. Ndaj vendimit ka ushtruar rekurs kërkuesja dhe motra e saj.

6. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2023-5519, datë 13.12.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqet e parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Ajo gjykatë ka arsyetuar se pretendimet në rekurs që ngrenë çështje të vlerësimit të provave, ishin jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë.

7. Në datën 06.05.2024 kërkuesja, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Ankimi, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 20.05.2024.

## II

### Pretendimet e kërkueses

8. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, për rrjedhojë edhe e drejta e pronës private, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

8.1. *Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit* i lidhur me të drejtën për t'u mbrojtur, dëgjuar dhe njoftuar, si dhe të drejtën për një gjykatë të paanshme, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk i kanë vlerësuar drejt provat duke mos marrë parasysh aktin e ekspertimit të shkallës së parë, por vetëm atë të realizuar në gjykatën e apelit. Në mënyrë të njëanshme gjykata e apelit ka riçelur hetimin gjyqësor, duke pranuar çdo provë të sjellë nga pala tjetër, si dhe nuk ka thirrur një grup ekspertesh edhe pse ka qenë përpara dy akteve të ekspertimit me konkluzione të ndryshme, duke zhvilluar kështu një hetim të paplotë dhe jo gjithëpërfshirës.

8.2. *Standardi i arsytimit të vendimit*, pasi në vendimin e gjykatës së apelit nuk janë pasqyruar saktë faktet, kërkesat dhe nuk janë rregulluar pasojat për të paditurën që ka hequr dorë nga ankimi. Në atë vendim është pasqyruar fakti që e paditura M.S. ka hequr dorë nga ankimi, por në pjesën hyrëse të vendimit thuhet se M.S. është në mungesë. Avokatët mbrojtës të të paditurave kanë ngritur pretendime që përfaqësonin edhe M.S., për të cilën nuk kanë pasur tagër përfaqësimi. Ndërsa

Gjykata e Lartë ka vendosur në kundërshtim me nenet 372 dhe 467 të KPC-së, pasi duhet të konstatonte problematikat procedurale dhe ta kthente çështjen për rigjykim në gjykatën e apelit.

8.3.E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, pasi gjykimi në gjykatat e faktit ka filluar në mars 2013 dhe ka përfunduar në korrik 2015, ndërsa në Gjykatën e Lartë çështja ka mbetur pa shqyrtuar për më shumë se 9 vjet, duke përfunduar në vitin 2023 dhe vendimi është arsyetuar në datën 04.04.2024.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkueses

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej këtyre kriterëve që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

10. Kërkuësja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës. Ajo është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Në nenin 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, përmbushja e këtij kriteri është detajuar

në dy hipoteza: i) kur kërkuesi ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive përpara se t'i drejtohet Gjykatës; ii) kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete juridike efektive në dispozicion. Ai përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t'i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Për sa më lart, Kolegji konstaton se kërkuesja, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, pasi gjykimi në gjykatat e faktit ka filluar në mars 2013 dhe ka përfunduar në korrik 2015, ndërsa në Gjykatën e Lartë çështja ka mbetur pa shqyrtuar për më shumë se 9 vjet, duke përfunduar në vitin 2023 dhe vendimi është arsyetuar në datën 04.04.2024.

13. Kolegji thekson se pas ndryshimeve që iu bënë KPC-së me ligjin nr. 38/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, legjislacioni i brendshëm parashikon tashmë mjete juridike që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e së drejtës kushtetuese për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe se individi duhet t'i shfrytëzojë ato përpara se t'i drejtohet Gjykatës (*shih vendimin nr. 3, datë 11.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Bazuar në standardet e mësipërme dhe rrethanat e çështjes konkrete, Kolegji vlerëson se kërkuesja i ka pasur të gjitha mundësitë t'i drejtohej Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, ndërkohë që nuk rezulton që ajo të ketë paraqitur ndonjë kërkesë të tillë sipas parashikimeve përkatëse të KPC-së. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se për këtë pretendim kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion dhe për këtë arsye nuk mund të merret në shqyrtim.

15. Pretendimet e tjera, kërkuesja ose i ka ngritur në substancë në rekurs, ose janë pretendime ndaj vendimit gjyqësor të Gjykatës së Lartë që ka përmbyllur procesin gjyqësor, për rrjedhojë për këto pretendime ajo e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive.

16. Një tjetër kriter paraprak është ai i legjitimitimit *ratione temporis*, që përcaktohet nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, në bazë të të cilit afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit. Në rastet e kundërshtimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës së Lartë, Gjykata e ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor duke filluar nga data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit

elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuësja ka përfunduar me vendimin e datës 13.12.2023 të Gjykatës së Lartë dhe kopja e tij i është dërguar avokates së kërkuëses në adresën e *e-mail*-it në datën 02.04.2024. Ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 06.05.2024, pra brenda afati ligjor 4-mujor. Për rrjedhojë, kërkesa e përmbush kriterin paraprak të legjitimitetit *ratione temporis*.

18. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji vërehen se kërkuësja ka pretenduar se në procesin gjyqësor të kundërshtuar është cenuar *parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit* i lidhur me *të drejtën për t'u mbrojtur, dëgjuar, njoftuar* dhe atë për një *gjykatë të paanshme*, pasi gjykatat nuk i kanë vlerësuar drejt provat duke mos marrë parasysh aktin e ekspertimit të shkallës së parë, por vetëm atë të realizuar në gjykatën e apelit. Në mënyrë të njëanshme gjykata e apelit ka riçelur hetimin gjyqësor duke pranuar çdo provë të sjellë nga pala tjetër, por nuk ka thirrur një grup ekspertesh edhe pse ka qenë përpara dy akteve të ekspertimit me konkluzione të ndryshme, duke zhvilluar një hetim të paplotë dhe jo gjithëpërfshirës. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se çështjet e interpretimit të ligjit dhe vlerësimit të fakteve dhe provave bëjnë pjesë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme, çka nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këto kushte, lidhur me këto pretendime, Kolegji vëren se, në thelb, ato kanë të bëjnë me vlerësimin e fakteve dhe provave nga gjykatat e zakonshme, për rrjedhojë nuk hyjnë në sferën e juridiksionit kushtetues. Nga ana tjetër, Kolegji vlerëson se kërkuësja nuk ka arritur të provojë në nivel kushtetues cenimin e së drejtës për t'u njoftuar, pasi nuk ka paraqitur asnjë argument për të mbështetur këtë pretendim. Rrjedhimisht, këto pretendime të kërkuëses nuk mund të merren në shqyrtim.

19. Në lidhje me pretendimin tjetër të kërkuëses për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, *prima facie* ai bën pjesë në juridiksionin kushtetues, rrjedhimisht do të analizohet në vijim.

#### *B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*

20. Kërkuësja ka pretenduar se në vendimin e gjykatës se apelit nuk janë pasqyruar saktë faktet dhe kërkimet, si dhe nuk janë rregulluar pasojat për të paditurën që ka hequr dorë nga ankimi. Ndërsa Gjykata e Lartë në vendimin e saj ka vendosur në kundërshtim me nenet

372 dhe 467 të KPC-së, pasi duhej të konstatonte problemet procedurale dhe ta kthente çështjen për rigjykim në gjykatën e apelit.

21. E drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Lidhur me këtë në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Ai, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje (*shih vendimet nr. 9 datë 20.01.2023; nr. 11, datë 24.05.2022; nr. 16, datë 16.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjykata në mënyrë konstante në jurisprudencën e saj ka pohuar se interpretimi i ligjit dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 32, datë 03.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Lidhur me vendimin e gjykatës së apelit, Kolegji konstaton se nuk rezulton që ajo gjykatë të jetë shmangur nga analiza dhe vlerësimi i provave të paraqitura nga kërkuesja dhe as nga kërkesat e ngritura prej saj. Përkundrazi, rezulton se pretendimet dhe provat e paraqitura prej kërkueses i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor dhe vlerësimit të gjykatës, të cilat, brenda kompetencës së saj, ka arritur në konkluzione të caktuara. Nga përmbajtja e vendimit të gjykatës së apelit, Kolegji konstaton se është përsëritur pjesërisht shqyrtimi gjyqësor për të realizuar një akt të ri ekspertimi. Për këtë qëllim, janë caktuar dy ekspertë kriminalistë, për të cilët nuk ka pasur kontestime nga palët. Ajo gjykatë ka vënë në dispozicion të ekspertëve modelet krahasuese të paraqitura nga palët ndërgjyqëse dhe të administruara si prova në gjykimin në shkallë të parë dhe në apel. Ekspertët kriminalistë kanë arritur në konkluzionin se nënshkrimi i trashëgimlënësit në testament ishte i njëjtë me modelet e paraqitura. Rezulton së gjatë shqyrtimit të aktit të ekspertimit, kërkuesja dhe e motra të kenë paraqitur pyetje shtesë dhe prova të reja për t'u ekzaminuar si modeleve krahasuese nga ekspertët. Në vijim, ekspertët kanë depozituar në gjykatë një shtesë të aktit të ekspertimit ku kanë arritur në përfundimin se ekzaminimi i modeleve të reja krahasuese nuk ndikonte në konkluzionin e dhënë në aktin e ekspertimit. Për më tepër, rezulton e sqaruar në përmbajtjen e vendimit të asaj gjykate se e paditura M.S. ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga ankimi por në kushtet kur ankimi rezultonte të ishte paraqitur edhe nga dy ankueset e tjera (në një akt të vetëm), heqja dorë nuk

përbente shkak për mosvazhdimin e gjykimit në gjykatën e apelit (*shih faqet 6–8 të vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës*).

24. Për sa i përket vendimit të Gjykatës së Lartë që ka vendosur mospranimin e rekursit, jurisprudenca kushtetuese ka pranuar se për këto vendime, kërkesat e një procesi të rregullt ligjor mund të plotësohen edhe me një arsytim të kufizuar të tyre (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Kolegji konstaton se vendimi i Gjykatës së Lartë përmban të dhënat e palëve dhe mënyrën se si kanë disponuar gjykatat më të ulëta, shkaqet e ngritura në rekurs, si edhe vlerësimin e asaj gjykate në lidhje me ato shkaqe. Gjykata e Lartë, pasi i ka marrë në vlerësim ato, është shprehur se rekursi nuk ngre shkaqe të bazuara nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së. Ajo ka vlerësuar se gjykata e apelit ka respektuar dhe zbatuar drejt dispozitat e ligjit material dhe se vendimi i saj nuk bie në kundërshtim me qëndrimet e Kolegjit Civil dhe të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, sipas asaj gjykate, pjesa e pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave, dilte jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë (*shih paragrafët 13-15 të vendimit nr. 00-2023-5519, datë 13.12.2023 të Gjykatës së Lartë*).

25. Për sa më lart, Kolegji konstaton se vendimet gjyqësore të kundërshtuara nuk rezultojnë të jenë alogjike dhe të kenë kundërthënie, ndërsa pjesa arsyetuese e tyre lidhet me përfundimin e arritur në dispozitiv. Vetëm fakti se konkluzionet e tyre nuk kanë shkuar në favor të pretendimeve të kërkuases, nuk vë në dyshim të drejtën e saj për proces të rregullt ligjor. Duke iu referuar në tërësi pretendimeve të kërkuases, rrethanave të çështjes konkrete, standardeve kushtetuese dhe arsytimit të vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, Kolegji vlerëson se kërkuases nuk i është cenuar e drejta për të pasur një vendim të arsyetuar.

26. Nën dritën e analizës së mësipërme, pretendimet e kërkuases për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor janë haptazi të pabazuara, për rrjedhojë edhe pretendimi i ndërlidhur për cenimin e së drejtës së pronës është haptazi i pabazuar.

27. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “a”, “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,



**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.